

MBI SHOQATËN E EKOLOGJISË BIMORE TË ALPEVE DINARIKE LINDORE (EADSVE)

ALEKO MIHO.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë

e-mail: aleko.miho@fshn.edu.al

Shoqata e Ekologjisë Bimore të Alpeve Dinarike Lindore (*The Eastern Alpine and Dinaric Society for Vegetation Ecology – EADSVE*; <http://www.eadsve.org/>) është themeluar në Klagenfurt (Austri) qysh në vitin 1960 me nismën e shkencëtarëve bimore: Erwin Aichinger nga Austria, Sandro Pignatti nga Italia dhe Maks Wraber nga Sllovenia. Presidenti i parë ishte Josias Braun-Blanquet (Montpellier). Në fillim ajo u krijua si një pjesë e Shoqatës Ndërkombëtare për Shkencën Bimore (*Vegetation Science*), por ajo veprimi në mënyrë të pavarur, dhe më pas u kthye në një shoqatë tërësisht e pavarur me emrin që mban sot. Zyra e regjistrimit të EADSVE është në Departamentin e Botanikës, Universiteti i Triestes, Itali.

Qëllimi i EADSVE është nxitja e bashkëpunimit ndërkufitar për studimet e bimësisë në rajonin e Alpeve Dinarike Lindore, kryesisht gjeobotanistë, fitosociologë, ekologë, fitogjeografë, taksonomistë, palinologë etj. Ajo ka veprimtari të pandërprerë që nga themelimi i saj duke organizuar takime, në të cilat mblidhen studiuesit, nxitet bashkëpunimi dhe mbështetet puna e përbashkët në projekte. Pjesëmarrja në takime nuk kufizohet vetëm tek anëtarët e shoqatës, por është hapur për gjithë shkencëtarët e interesuar për florën dhe bimësinë e rajonit dhe më gjerë.

Deri në vitin 1972 takimet u mbajtën në çdo vit, dhe më pas çdo dy vjet, duke u mbajtur çdo herë në një vend tjetër, dhe për një çështje të caktuar. Si veprimtari shtesë organizohen edhe ftesa për diskutime të veçanta dhe dalje në terren. Takimet dhe daljet në terren japin mundësinë e vendosjes së kontakteve personale mes shkencëtarëve bimore, duke lehtësuar shkëmbimin e të dhënave dhe përvojave. Në mënyrë të veçantë EADSVE u jep shkencëtarëve të rinj mundësinë të paraqesin veten dhe punën e tyre me prezantime dhe postera.

Anëtarët vijnë kryesisht nga pjesët jugore dhe juglindore të Evropës, por EADSVE është e hapur për shkencëtarët e bimësisë nga të gjitha vendet. Lista e anëtarëve të nderit është me mbi 210 botanistë të shquar nga Kroacia (57 anëtarë), Austria (45), Italia (41), Sllovenia (27), Gjermania (10), Kosova (10), Hungaria (6), Maqedonia (5), Serbia (6), Turqia (4), Zvicra (4), Bosnja dhe Hercegovina (1), Bullgaria (1), Franca (1), Sllovakia (1). Në fillim gjuhët gjermane, italiane, serbo-kroate dhe sllovene ishin gjuhë të barabarta nëpër takime. Më pas, gjermanishtja u bë gjuha kryesore e takimeve. Në 1994 në takimin Zagrebit, u shtua edhe gjuha angleze në listën e gjuhëve; gjuha angleze është sot gjuha sunduese në gjithë takimet.



Sivjet u organizua takimi i 37-të i EADSVE, i cili u mbajt në Prizren, Kosovë, nga 13 deri më 16 korrik 2017, nën kujdesin e Universitetit 'Ukshin Hoti' të Prizrenit dhe Universitetit 'Haxhi Zeka' të Pejës. Përveç 5 seksioneve me kumtesa dhe 1 seksioni posterash në ditën e parë, në dy ditët e tjera u organizuan dalje në terren, një në malin e Sharrit (Oshlak, rreth 1900 m) dhe një në rrethinat e Prizrenit (Grykë e Prizrenit dhe Zhur). Në këtë takim, President i radhës u zgjodh Christian Eichberger (Salzburg, Austri). Takimi i radhës pas dy vjetësh u vendos të organizohet në Universitetin e Kamerinos, Itali.

Në takim u përfaqësuan për herë të parë edhe botanistët shqiptarë nga FShN, UT, me një kumtesë dhe një poster. Në kumtesë u bë një përmbledhje e florës dhe bimësisë së Alpeve Shqiptare - shkalla e ruajtjes dhe kërcënimeve (A. Miho, si bashkëautor përfaqësues); kurse posteri trajtoi parazitizmin haustorial në florën shqiptare (O. Saliq, si bashkëautore përfaqësuese). Dy këta pjesëmarrës nga Shqipëria u pranuan si anëtarë të EADSVE.

Me këtë informacion dëshiroj të shpreh përgëzimet e mia për gjithë kontributin e EADSVE, mirënjohjen dhe falenderimet për organizatorët kosovarë, si për organizimin e shkëlqyer dhe për pritjen e ngrohtë që na ofruan. Nga ana tjetër, nxit botanistët shqiptarë të ndjekin aktivitetet e kësaj Shoqate me përvojë për të mirën e përparimit të shkencës bimore shqiptare dhe në rajon.